

Fondi i Investimit Raiffeisen MKS

Raportimet Financiare për tremujorin IV 2025 për
Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare

Janar 2026

Pasqyrat financiare të Raiffeisen Invest -Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kollective	
Informacioni	Përshkrimi, vlera
Kodi i shoqërisë administruese	K51928001I
Numri i regjistrimit në QKR	
Numri për raportimin	1
Adresa	Rruga Abdyl Frasheri,EGT Tower,Tirane
Telefon/fax	+355 694040481
Email:	Edlira.konini@raiffeisen.al
Faqe Web	www.raiffeisen-invest.al
Data e licensimit	18 Tetor 2010
Administrativ	Donalda Gjorga - Kryetare
	Peter Zilinek-Zv.Kryetar
	Juela Ahmeti-anëtar
	Elona Llaci-anëtare
	Gentjana Ciceri-anëtare
	Edlira Konini-anëtare
i shoqërisë dhe adresa e zyrtare, përqindja e aksioneve në pronësi)	
Emri i shoqërisë	Raiffeisen Bank Albania
Adresa zyrtare	Rruga e Kavajes
Përqindja e aksioneve	100%
Numri i punonjësve	16
Shoqëria e ekspertit kontabël që ka audituar e fundit pasqyrat fi	Deloitte Audit Albania Sha
Banka (depozitari) me të cilin kryen veprimet shoqëria e administ	First Investment Bank, Albania
Numrat e llogarive:	
Nr e llogarive të Shoqërisë Administruese:	
Raiffeisen Bank	AL75 2021 1037 0000 0000 0095 9145
Raiffeisen Bank	AL58 2021 1037 0000 0002 7095 9145
Raiffeisen Bank	AL75 2021 1013 0000 0000 1295 9145
First Investment Bank Albania	AL18 2151 1031 ALL1 0000 0401 7500
Nr e llogarive të Fondit të Pensionit Vullnetar Raiffeisen:	
First Investment Bank Albania	AL78 2151 1031 ALL1 0000 0393 3000
Nr i llogarisë të Fondit të Investimit Raiffeisen Prestigj:	
First Investment Bank Albania	AL43 2151 1031 ALL1 0000 0524 4100
Nr i llogarisë të Fondit të Investimit Raiffeisen Invest Euro:	
First Investment Bank Albania	AL03 2151 1031 EUR1 0000 0610 6600
Nr i llogarisë të Fondit të Investimit Raiffeisen Vizion:	
First Investment Bank Albania	AL60 2151 1031 ALL1 0000 1172 3200
Nr i llogarisë të Fondit të Investimit Raiffeisen Miks:	
First Investment Bank Albania	AL32 2151 1031 EUR1 0000 1473 1900
Nr i llogarisë të Fondit të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid	
First Investment Bank Albania	AL48 2151 1031 EUR1 0000 1987 3000

Pasqyrat financiare të fondit të investimit Raiffeisen MIX

1. Pasqyra e asetëve të fondit Raiffeisen MIKS

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen MIKS**

Kodi i fondit të investimit: **FI-B6**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/12/2025**

	Lek	Lek
Zërat e aktivitetit	31/12/2024	31/12/2025
1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare , depozite	19,696,926.52	21,538,961.12
2. Investime (2a+2b+2c+2d+2d)	350,596,517.49	378,176,203.01
2a. Letra borxhi të blera në emetimin e parë	0.00	0.00
2a.1 Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humb	0.00	0.00
2a.2 Investime financiare të vlefshme për shitje		
2a.3 Investime financiare të mbajtura deri në maturim		
2b. Letra borxhi të blera në treg sekundar	183,475,053.58	180,055,661.77
2b.1 Investime financiare me vlerë të drejtë ndërmjet fitimit dhe humb	183,475,053.58	180,055,661.77
2b.2 Investime financiare të vlefshme për shitje		
2b.3 Investime financiare të mbajtura deri në maturim		
2c. Depozita		
2d. Kuota në fonde Investimi	167,121,463.91	198,120,541.24
2e. Kuota në EFT	0.00	0.00
3. Llogari të arkëtueshme	2,751,469.39	3,143,513.57
3a. Të arkëtueshme nga shitja e letrave me vlerë		
3b. Të arkëtueshme nga shoqëria administruese dhe Banka depozitare		
3c. Të arkëtueshme nga depozitari	15,015.97	166,394.08
3d. Parapagime		
3e. Të arkëtueshme nga ndryshimi i anëtarësisë		
3f. Të tjera llogari të arkëtueshme	2,736,453.42	2,977,119.50
A (1+2+3) TOTALI I AKTIVEVE	373,044,913.40	402,858,677.70
4. Detyrime nga investimi në letrat me vlerë		
5. Detyrime nga investimi në depozita		
6. Detyrime ndaj shoqërisë administruese	388,771.17	430,458.12
7. Detyrime ndaj depozitarit	19,436.64	21,521.65
8. Detyrime nga ndryshimi i anëtarësisë (shlyerje)		
9. Pagesa të shtyra dhe të ardhura të marra në avancë		
10. Detyrime të tjera	361,492.34	310,575.57
B (4+5+6+7+8+9+10) TOTALI I PËRGJEGJËSIVE	769,700.15	762,555.34
C (A-B) AKTIVET NETO TË FONDIT TË INVESTIMIT	372,275,213.25	402,096,122.36
D Numri i kuotave të fondit të investimit të emetuara	35,775.79	37,043.4877
E (C/D) AKTIVET NETO PËR KUOTË TË FONDIT TË INVESTIMIT	10,405.79	10,854.7048

2. Pasqyra e veprimtarisë së fondit të investimit Raiffeisen MIX

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen Miks**

Kodi i fondit të investimit: **FI-B6**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/12/2025**

		31/12/2024	31/12/2025
Nr.	Zerat		
	TË ARDHURA NGA INVESTIMET		
1	Fitime të realizuara nga shitja e investimeve në letra me v	3,133,919.75	1,488,127.93
2	Të ardhura nga interesat	6,351,026.60	5,747,814.81
3	Diferenca pozitive të kurseve të këmbimit nga mjetet mon	3,395,830.31	1,779,918.32
4	Të ardhura nga dividendët	2,291,965.32	2,003,707.30
5	Të ardhura të tjera	88,130.14	60,928.81
A (1+2+3+4+5)	TOTALI I TË ARDHURAVE NGA INVESTIMET	15,260,872.12	11,080,497.17
	SHPENZIMET		
6	Humbje të realizuara nga shitja e investimeve në letra me	6,775,115.45	1,001,661.37
7	Diferenca negative të kurseve të këmbimit nga mjetet mo	4,212,491.67	1,913,483.11
8	Tarifa për shoqërinë administruese	4,619,213.03	4,865,893.77
9	Tarifa për depozitarin	364,698.34	314,057.55
10	Shpenzime të tjera	700,256.22	592,469.00
B (6+7+8+9+10)	TOTALI I SHPENZIMEVE	16,671,774.71	8,687,564.80
C (A-B)	FITIMI (HUMBJA) NETO NGA INVESTIMET, +/-	-1,410,902.59	2,392,932.37
	FITIMI (HUMBJA) E PAREALIZUAR NGA INVESTIMET NE LETRA ME VLERË		
d1	Fitimi (humbja) e perealizuar nga investimet në letra me v	19,488,795.48	17,326,292.71
d2	Ndryshime neto prej kurseve të këmbimit në investimet në letra me vlerë	-13,771,423.00	-4,413,206.01
d3	Amortizimi i primit/diskountit të aktiveve me afat maturimi fiks.		
d4	Zhvlerësim i aktiveve		
D (d1+d2+d3+d4)	TOTALI I FITIMEVE (HUMBJEVE) TË PAREALIZUARA NGA INVESTIMET NË LETRA ME VLERË, +/-	5,717,372.48	12,913,086.70
E (C+D)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NETO I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT	4,306,469.89	15,306,019.07

3. Pasqyra e ndryshimeve në asetet neto

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen Miks**

Kodi i fondit të investimit: **FI-B6**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/12/2025**

		Lek	Lek
		31/12/2024	31/12/2025
	Zërat		
	RRITJA (ZVOGËLIMI) I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT		
1	Fitimi (Humbja) neto nga investimet, +/	-1,410,902.59	2,392,932.37
2	Totali i fitimeve (humbjeve) të përealizuara nga investimet në letra me vlerë, +/-	5,717,372.48	12,913,086.70
3	Rivlerësimi i aktiveve financiare të vlefshme për shitje		
	RRITJA (ZVOGËLIMI) I AKTIVEVE NETO NGA VEPRIMTARIA E FONDIT		
A (1+2+3)	FONDIT	4,306,469.89	15,306,019.07
4	Kontribute nga anëtarët e fondit	228,372,714.19	83,125,341.10
5	Tërheqje për shkak të ndryshimit të anëtarësisë	-271,009.53	0.00
6	Tërheqje për pagesat e përfitimeve / tërheqje nga fondi	-180,215,759.02	-68,610,451.06
	RRITJA (ZVOGËLIMI) NË TOTAL NGA TRANSAKSIONET ME KUOTAT , +/-	47,885,945.63	14,514,890.04
B (4-5-6)	RRITJA (ZVOGËLIMI) NË TOTAL I AKTIVEVE NETO, +/-	52,192,415.52	29,820,909.11
D	AKTIVET NETO	372,275,213.23	402,096,122.34
7	Në fillim të periudhës	320,082,797.70	372,275,213.25
8	Në fund të periudhës	372,275,213.22	402,096,122.36
	NUMRI I KUOTAVE TË FONDIT TË INVESTIMIT		
9	Kuota të investimit të emetuara mbi bazën e investimeve	22,132.56	7,815.26
10	Kuota të investimit të tërhequra mbi bazën e ndryshimit të anëtarësisë (-)	-25.93	0.00
11	Kuota të investimit të tërhequra për shkak të pagesave të përfitimeve/ shlyerje	-17,625.96	-6,547.56
E (9-10-11)	NUMRI I KUOTAVE TË INVESTIMIT	4,480.67	1,267.70

4. Pasqyra mbi kuotat e fondit Raiffeisen MIKS

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen MIKS**

Kodi i fondit të investimit: **FI-B6**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/12/2025**

	Numri i kuotave të fondit	Aktivitet e fondit (Lek)	Aktive për kuotë (Lek)
Lloji			
Në fillim të periudhës 31/12/2024	35,775.7913	372,275,213.25	10405.7856
Emetuar gjatë periudhës	7,815.2581	83,125,341.10	10,636.29
Tërhequr për shkak të largimit nga fo	-6,547.5617	-68,610,451.06	10,478.78
Në fund të periudhës 31/12/2025	37,043.4877	402,096,122.36	10,854.70

4.1. Pasqyra e treguesve te vecante të fondit të investimit

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen MIKS**

Kodi i fondit të investimit: **FI-B6**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/12/2025**

Gjendja		Lek
		31/12/2025
Asetet neto te fondit		402,096,122.36
Numri i kuotave te fondit		37,043.49
Vlera neto e aseteve per kuotë		10,854.70
Numri i kuotave ne fillim te periudhes		35,775.79
Numri i kuotave te emetuara		7,815.26
Numri i kuotave të shlyera		-6,547.56
Numri i kuotave ne fund të periudhës		37,043.49
Raporti i shpenzimeve totale		1.30%
Fitim i paguar për kuotë		
Kthimi total		5.80%
Vlera me e ulët e vlerës neto të aseteve për kuotë		9,892.29
Vlera me e lartë e aseteve neto për kuotë		10,854.70
Vlera më e ulët e aseteve neto		352,191,012.11
Vlera më e lartë e aseteve neto		402,096,122.36
Personat juridikë,ndermjetesues ne transaksionet me letrat me vlerë që kanë kryer më tepër se 10 % të transaksioneve në peridhën aktuale		
Personat juridikë për ndermjetësimin në tregtimin e letrave me vlerë	Vlera e transaksioneve të kryera përmes personave juridikë si përqindje e vlerës totale të të gjitha transaksioneve në periudhën aktuale	Komisionet e paguara tek personat juridikë për ndërmjetësimin si përqindje e vlerës totale të të gjitha transaksioneve të

5. Pasqyra e strukturës së investimeve
5.1 Obligacionet

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen MIKS**
Kodi i fondit të investimit: **FI-B6**
Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**
Për periudhën: **31/12/2025**

Lloji	Vlera nominale (Lek)	Shpenzimet e blerjes (Lek)	Vlera në datën e raportimit (Lek) 31/12/2025	Pjesa ndaj kapitalit të emetuesit, %	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
Obligacione të Qeverisë (brenda vendit)	105,479,300.00	106,555,299.60	107,624,768.32		26.72%
HFT	105,479,300.00	106,555,299.60	107,624,768.32		0.00%
Primar	0.00	0.00	0.00		0.00%
					0.00%
Secondar	105,479,300.00	106,555,299.60	107,624,768.32		26.72%
TOTALI I OBLIGACIONEVE TË EMETUESVE VENDAS	105,479,300.00	106,555,299.60	107,624,768.32		26.72%
Obligacione të Qeverisë (jashtë vendit)	26,127,900.00	26,235,986.16	25,988,357.66		6.45%
Obligacione të shoqërive (jashtë vendit)	48,385,000.00	46,538,216.15	46,442,535.79		11.53%
TOTALI I OBLIGACIONEVE TË EMETUESVE TË HUAJ	74,512,900.00	72,774,202.31	72,430,893.45		17.98%
TOTALI	179,992,200.00	179,329,501.91	180,055,661.77		44.69%

5. Pasqyra e strukturës së investimeve
5.3 Investime të tjera

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen MIKS**
Kodi i fondit të investimit: **FI-B6**
Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**
Për periudhën: **31/12/2025**

	Vlera në datën e raportimit (Lek)	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (brenda vendit)	21,538,961.12	5.35%
Aktive të tjera (brenda vendit)		
TOTALI BRENDA VENDIT	21,538,961.12	5.35%
të mjeteve monetare (jashtë vendit)		
Aktive të tjera (jashtë vendit)		
TOTALI JASHTË VENDIT		

5. Pasqyra e strukturës së investimeve

5.4 Kuota ne fonde te tjera investimi

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen MIKS**

Kodi i fondit të investimit: **FI-B6**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/12/2025**

Lloji	Vlera nominale (Lek)	Shpenzimet e blerjes (Lek)	Vlera në datën e raportimit (Lek)	Pjesa ndaj totalit të aktiveve të fondit, %
Kuota ne fonde te tjera Investimi (jashte vendit)	289,442,406.63	185,933,614.41	198,120,541.24	49.18%

6. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të realizuara te fondit

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen MIKS**

Kodi i fondit të investimit: **FI-B6**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/12/2025**

Data e shitjes	Instrumentet Financiare	Kategoria e asetëve financiare sipas IAS 39	Shuma apo Vlera nominale (Lek)	Vlera kontabel e drejte (Lek)	Vlera e shitjes dhe maturimit	Fitimi (Humbja) e realizuar (Lek)
1	2	3	4	5	6	7 (6-5)
	Aksione te zakonshme					
	Aksione preferenciale					
	Aksione te shoqerive te investimit					
	Obligacione qeveritare		17,418,600.00	17,698,996.90	17,921,995.27	222,998.37
	Obligacione bashkiake					
	Obligacione te shoqerive		29,031,000.00	28,860,811.20	29,120,951.00	260,139.80
	Boni thesari					
	Emetime te bankes qendrore					
	Deftesa tregtare					
	Kouta te fondeve te investimit		1,874.00	33,841,452.58	33,844,780.97	3,328.39
	Kuota ne EFT					
	Letra te tjera me vlere					
	Letra me vlere te strukturuara me vlere te drejte					
	Letra me vlere te strukturuara me derivate te perfshira					
	Instrumente derivative					
	Totali i fitimit (humbjes) se realizuar		46,451,474.00	80,401,260.68	80,887,727.24	486,466.56

	Ripermbledhja sipas kategorive te asetëve financiare		46,451,474.00	0.00	80,887,727.24	486,466.56
	Fitimi (humbje) te ralizuara nga astete financiare me vlere te drejte		46,451,474.00		80,887,727.24	486,466.56
	Fitimi (humbje) te ralizuara nga astete financiare te disponueshme per shitje					
	Fitimi (humbje) te ralizuara nga astete financiare te mbajtura ne maturim					

Kategorizimet jane ne perputhje me IAS 39

7. Pasqyra e fitimeve (humbjeve) të perealizuara te fondit

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen MIKS**

Kodi i fondit të investimit: **FI-B6**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/12/2025**

Data e shitjes	Instrumentet Financiare	Kategoria e asetëve financiare sipas IAS 39	Vlera e tregut (Lek) 01.01.2025	Vlera kontabel e drejte (Lek)	Fitimet(humbjet) e perealizuara te njohura drejtpërdrejtë përmes fitimit(humbjes)	Diferenca neto në kursin e kembimit për investimet në letra me vlerë
	Aksione të zakonshme					
	Aksione preferenciale					
	Aksione të shoqërive të investimit					
	Obligacione qeveritare		132,791,285.75	133,613,125.98	2,473,939.57	- 1,652,099.33
	Obligacione bashkiake					
	Obligacione të shoqërive		46,538,216.15	46,442,535.79	414,756.22	- 510,436.58
	Boni thesari					
	Emetime të bankës qendrore					
	Deftesa tregtare					
	Kouta të fondeve të investimit		185,933,614.41	198,120,541.24	14,437,596.92	- 2,250,670.09
	Kuota në EFT		-	-	-	-
	Letra të tjera me vlerë					
	Letra me vlerë të strukturuar me vlerë të drejte					
	Letra me vlerë të strukturuar me derivate të perfshira					
	Instrumente derivative					
	Totali i fitimit (humbjes) se perealizuar		365,263,116.31	378,176,203.01	17,326,292.71	-4,413,206.01
	Ripërmbledhja sipas kategorive të asetëve financiare					
	Fitimi (humbje) të perealizuara nga astete financiare me vlerë të drejte		365,263,116.31	378,176,203.01	17,326,292.71	-4,413,206.01
	Fitimi (humbje) të perealizuara nga astete financiare të disponueshme për shitje					
	Fitimi (humbje) të perealizuara nga astete financiare të mbajtura në maturim					

Kategorizimet janë në përputhje me IAS 39

8. Pasqyra e fluksit te parase

Emri i fondit të investimit: **Raiffeisen MIKS**

Kodi i fondit të investimit: **FI-B6**

Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**

Për periudhën: **31/12/2025**

Gjendja	Lek
	31/12/2025
FLUKSI I PARAVE NGA AKTIVITETI	-15,646,898.60
Hyrje nga shitja e asetave afatgjata (T-Bonds)	52,851,166.31
Dalje për blerjen e asetave afatgjata (T-Bond)	-42,775,518.70
Hyrje nga shitja e kuotave te fondeve te tjera te investimit	33,857,009.28
Dalje nga blerja e kuotave te fondeve te tjera te investimit	-52,689,523.83
Hyrje nga interesat ne llogari rrjedhese	
Dalje për pagime interesash	
Hyrje nga investimi ne instrumente borxhi dhe llogari te	164,047,900.97
Dalje per shkak të investimit në instrumente borxhi dhe	-166,625,150.00
Hyrja nga investimi në asete financiare afatshkurter (T-	
Dalje për investimin në asete financiare afatshkurter (T-	
Hyrje nga shoqëria administruese	
Dalje për pagimin e tarifave të shoqërisë administruese	-4,832,639.89
Hyrje nga depozitari	
Dalje për pagimin e tarifave të depozitarit	-241,694.19
Dalje për kosto transaksionesh	-29,650.34
Dalje për pagim taksash	-454,181.27
Hyrje të tjera nga aktiviteti	1,883,207.98
Dalje të tjera nga aktiviteti	-637,824.92
FLUKSI I PARAVE NGA AKTIVITETI I FINANCIMIT	14,918,268.34
Hyrje nga emetimi i kuotave	83,125,347.97
Dalje për shlyerjen e kuotave	-68,207,079.63
Dalje për pagesat për kuotambajtesit për ndarjen e fitimeve	
Hyrje të tjera nga aktiviteti i financimit	
Dalje të tjera nga aktiviteti i financimit	
EFEKTET E NDRYSHIMIT NË KURSET E KEMBIMIT	-77,135.14
RRITJA (ZBRITJA) NETO NË FLUKSIN E PARAVE	-805,765.40
GJËNDJA E PARAVE NË FILLIM TË PERIUDHËS	1,539,176.52
GJËNDJA E PARAVE NË FUND TË PERIUDHËS	733,411.12

9. Raporti i transaksioneve me palët e lidhuraEmri i fondit të investimit: **Raiffeisen MIKS**Kodi i fondit të investimit: **FI-B6**Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**Për periudhën: **31/12/2025**

Emri i palës së lidhur	Përshkrimi i transaksionit	Data e transaksio	Shuma ose vlera	Kosto e blerjes	Vlera e transaksioni	Fitimi (humbja e
Shoqëria e administrimit	Tarifa e administrimit				4,865,893.77	
Sipërmarrje investimi e administruar nga shoqëria administruese						
Depozitari	Tarifa e kujdestarit				243,675.46	
	Kosto transaksionesh				29,404.86	
Firmë ligjore						
Konsulent taksash/eksper t kontabël						
Institucion krediti apo investues						

10. Raporti mbi pozicionet që rrjedhin me palët e lidhura me sipërmarrjen e investimeveEmri i fondit të investimit: **Raiffeisen MIKS**Kodi i fondit të investimit: **FI-B6**Emri i shoqërisë administruese: **Raiffeisen Invest**Për periudhën: **31/12/2025**

Emri i palës së lidhur	Asetet	Detyrimet	Të ardhurat	Shpenzimet
Shoqëria e administrimit		430,458.12		4,865,893.77
Sipërmarrje investimi e administruar nga				
Depozitari	733,411.12	21,521.65		272,704.99
Firmë ligjore				
Konsulent taksash/ekspert kontabël				

1. HYRJE

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendimin nr. 179, datë 13/12/2011, licensoi Shoqërinë Raiffeisen Invest-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a për të kryer veprimtarinë e administrimit të aseteve të sipërmarrjeve të Investimeve kolektive, krahas veprimtarisë së administrimit të fondeve të pensionit vullnetar (Licenca nr.1, datë 13.12.2011).

Gjithashtu, me Vendimin nr. 190, datë 16.12.2020, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratoi Fondin e Investimit Raiffeisen MIKS (Kodi FI-B6), nën administrimin e Raiffeisen Invest sh.a.

Raiffeisen Invest sh.a aktualisht administron kater fonde investimi "Fondi Raiffeisen Prestigj", "Fondi Raiffeisen Vizion", "Fondi Raiffeisen Miks" "Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid" si dhe "Fondi Raiffeisen Invest EURO", te cilët nuk është entitet ligjor dhe nuk ka personalitet juridik.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar First Investment Bank Albania sh.a. si bankë depozitare e Fondit të Investimit Raiffeisen MIKS. Shoqëria Administruese dhe Depozitari do të mbajnë aktivet, veprimet dhe regjistrimet e veta të ndara nga aktivet, veprimet dhe regjistrimet kontabël të Fondit Raiffeisen MIKS.

2. BAZAT E PËRGATITJES

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet e përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

b) Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike, me përjashtim të aktiveve financiare për tregtim, të cilat janë matur me vlerën e drejtë përmes fitimit apo humbjes.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në monedhën shqiptare "Lek", e cila është monedha prezantuese.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në këto pasqyra financiare.

- **Aktivet dhe detyrimet financiare**

Fondi klasifikon aktivet financiare në kategoritë: me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes, të mbajtura deri në maturim, të vlefshme për shitje dhe llogari të arkëtueshme.

i Njohja

Aktivet financiare njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në ditën kur entiteti bëhet palë kontraktuale në lidhje me një instrument në përputhje me blerjen e rregullt të tij. Një mënyrë e rregullt blerjeje ose shitjeje e një instrumenti financiar njihet si data kontabilizimi të aktivit, datën e shlyerjes. Dita e shlyerjes është dita kur aktivi i levrohet entitetit. Dita e shlyerjes i referohet a) njohjes së aktivit në ditën kur ai merret nga entiteti b) c'regjistrimit të aktivit dhe njohjes së fitimit/humbjes neto nga shitja në ditën kur ai livrohet/dergohet nga entiteti. Kur aplikohet dita e shlyerjes, entiteti kontabilizon çdo ndryshim në vlerën e drejtë të aktivit gjatë periudhës midis datës së tregtimit dhe datës së shlyerjes. Me fjalë të tjera, ndryshimi në vlerë nuk njihet për aktivet të mbajtura me kosto ose kosto të amortizuar; por njihet si fitim ose humbje për aktivet e klasifikuara si aktive financiare të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes; dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për aktivet e vlefshme për shitje.

Detyrimet njihen fillimisht në datën kur entiteti bëhet palë e kontratës.

Ç'regjistrimi

Fondi c'regjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të parase nga aktivi financiar, ose kur të drejtat për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale të aktivit financiar janë transferuar në një transaksion me të cilin transferohen kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiv financiar. Fondi nuk njihet një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo kanë përfunduar.

Fondi merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të gjitha ose kryesisht në të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Në transaksionet në të cilat Fondi as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivet financiare, aktivi ç'regjistrohet nëse kontrolli mbi to humbet.

ii Matja e vlerës së drejtë

Pas njohjes fillestare të gjitha aktivet financiare (përveç atyre të mbajtura deri në maturitet) maten me vlerën e drejtë. Përkufizimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është përcaktuar duke përdorur teknika të vlerësimit. Metodën e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara dhe krahasimin me instrumente të tjerë të ngjashëm, për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Ndryshimet në vlerën e drejtë janë njohur menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

iii Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Fondi vlerëson, nëse ka një evidencë objektive që aktivet financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim - humbjes, janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe që ngjarja që sjell humbje ka ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

iv v. Investime të mbajtura deri në maturim

Investimet e mbajtura deri në maturim janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të fiksuar që Shoqëria ka synimin e qartë dhe aftësinë për të mbajtur deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose në dispozicion për shitje. Investimet e mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim që nuk janë afër maturimit të tyre do të rezultonte në riklasifikimin e të gjithë investimeve të mbajtura deri në maturim si të disponueshme për shitje, dhe do të parandalonte Kompaninë të klasifikonte letrat me vlerë për qëllime investimi si instrumenta të mbajtura deri në maturim për periudhën aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

vi. Investimeve të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes

Fondi mban disa instrumenta me vlerën e drejtë, me ndryshimet e vlerës së drejtë të njohura menjëherë në fitim ose humbje, siç përshkruhet në politikën kontabël 2 (c) (iii). Një prezantim të detajuar të matjeve të vlerës së drejtë mund ta gjeni në shënimin 6 dhe 7.

- **Paraja dhe ekuivalentët e saj**

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë aktive financiare me shkallë likuiditeti të lartë me maturitet më të vogël se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Fondi për administrimin e angazhimeve afat-shkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në pasqyrën e pozicionit financiar me kosto të amortizuar.

- **Llogaritë e arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e drejtë dhe maten në vazhdim me kosto të amortizuar, duke i zbritur zhvlerësimin.

- **Llogaritë e arkëtueshme dhe pagueshme nga letrat me vlerë.**

Llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme të cilat përdoren në momentin e blerjes dhe shitjes së letrave me vlerë janë njohur si aktive dhe detyrime në datën e transaksionit, datë e cila është e njëjtë me atë të pagesës.

- **Llogaritë e pagueshme**

Llogaritë e pagueshme janë mbajtur me kosto të amortizuar.

4. STRATEGJIA E INVESTIMEVE TË ASETEVE TË FONDIT TË INVESTIMIT RAIFFEISEN MIKS.

Strategjia e investimeve të aktiveve të Fondit të Investimit Raiffeisen Invest Miks mbështetet në ligjin nr 56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" dhe rregulloret e dala në zbatim të tij, si dhe në politikën e brendshme të investimit të shoqërisë administruese, propozuar nga Komiteti i Investimit dhe miratuar nga Këshilli i Administrimit të shoqërisë.

4.1 Kuadri ligjor

Në lidhje me investimet e aktiveve të Fondit, Raiffeisen Invest sh.a i përmbahet ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 "Për Sipërmarrjet e Investimeve kolektive", si dhe Prospektit të Fondit.

4.1.1 Investimet e lejuara

Sipas ligjit nr.56/2020, datë 30.04.2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", portofoli i Fondit mund të përbëhet nga:

- ✓ tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit Europian apo në ëdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja;
- ✓ kuota të fondeve të investimit apo aksione të shoqërive të investimit, të licencuara sipas ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të licencuara në përputhje me standardet e Bashkimit Europian;
- ✓ depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në ëdo shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë se 12 muaj;
- ✓ instrumente financiare derivative;
- ✓ instrumente të tjera të tregut të parasë.

Për secilin prej instrumentave të mësipërm, shoqëria administruese angazhohet se do të respektojë kufizimet e investimit të parashikuara në Ligjin nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe ato të parashikuara në politikën e brendshme për manaxhimin e riskut.

4.2 Politika e brendshme e investimit e shoqërisë administruese

Sipas ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", portofoli i Fondit mund të përbëhet nga:

- tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë, në një shtet të Bashkimit Europian apo në çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja;
- kuota të fondeve të investimit apo aksione të shoqërive të investimit, të licencuara sipas ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe nga kuota ose aksione të sipërmarrjeve kolektive të investimit, të licencuara në përputhje me standardet e Bashkimit Europian;
- depozita në institucione kreditimi, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në një nga shtetet anëtare të BE-së ose në çdo shtet të lejuar nga AMF-ja, të cilat mund të tërhiqen menjëherë ose që kanë afat maturimi jo më shumë se 12 muaj;
- instrumente financiare derivative;
- instrumente të tjera të tregut të parasë.

Për secilin prej instrumenteve të mësipërm, shoqëria administruese angazhohet se do të respektojë kufizimet e investimit të parashikuara në Ligjin nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", si dhe ato të parashikuara në politikën e brendshme për manaxhimin e rrezikut.

KATEGORITË E ASETVE	*SHPËRNDARJA E SYNUAR E ASETVE	KUFIZIMET E SHPËRNDARJES	
Tituj borxhi të emetuar nga shtete /shoqëri tregtare, të tregtuara në tregje të rregulluara & kuota të fondeve të investimit, të cilat i përkasin kategorisë me Gradë Investimi	30%	30%	Maksimum
Tituj borxhi të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, vende europiane në zhvillim, nga shoqëri tregtare, të tregtuara në tregje të rregulluara & kuota të fondeve të investimit, të cilat i përkasin kategorisë Nën Gradë Investimi	38%	45%	Maksimum
Tituj që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në vende të zhvilluara si SHBA, Kanada, vendet e BE, Zvicër apo vendet e Paqësorit. Këto tituj janë në formën e aksioneve individuale ose kuota të fondeve të investimit të tregtuara ose jo në bursë.	25%	40%	Maksimum
Tituj që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në vende në zhvillim në Europë ose Azi. Këto tituj janë në formën e aksioneve individuale ose kuota të fondeve të investimit të tregtuara ose jo në bursë.	5%	8%	Maksimum
Depozita bankare, marrëveshje të anasjellta të riblerjes, cash dhe ekuivalentë cash-i	2	80%	Maksimum

Risku i investimit merret përsipër vetëm nga anëtarët e Fondit dhe jo nga shoqëria administruese. Për të minimizuar këtë risk, shoqëria administruese ka në strukturën e saj organizative një Komitet Investimi i cili propozon politikën e shpërndarjes së asetëve dhe të investimit dhe një njësi të Manaxhimit të Riskut që kryen kontrollin sasior e cilësor të të gjitha llojeve të risqeve që lidhen me Fondin.

- **Vlera Neto e Aktiveve të Fondit Raiffeisen Miks**

Vlera e aktiveve neto është e barabartë me totalin e aktiveve neto minus detyrimet e Fondit.

- **Vlera e kuotës së Fondit Raiffeisen Miks**

Vlera e kuotës është e barabartë me vlerën e aktiveve neto të Fondit pjesëtuar me numrin e kuotave në datën e raportimit. Vlera fillestare e kuotës ka qenë e barabartë me 100 Euro, në përputhje me politikën e Fondit.

- **Të ardhurat nga interesat**

Të ardhurat nga interesat përfshijnë të ardhurat nga interesat e kuponave të obligacioneve dhe interesat nga depozitat. Të ardhurat nga interesat janë regjistruar sipas parimit të interesave të përlogaritura.

- **Tarifa për shoqërinë administruese.**

Fondi i detyrohet t'i paguajë shoqërisë administruese një tarifë prej 1,3% (në bazë vjetore) të aktiveve neto, shpenzim për Fondin i cili përlogaritet në bazë ditore.

- **Fitim/ humbje të realizuara**

Të ardhurat/humbjet e realizuara ndodhin për shkak të shitjes së letrave me vlerë me diferencë nga çmimi i ofruar me vlerën e principaleve dhe interesave të maturuara në letrat me vlerë të blera me premium ose discount. Këto fitim/humbje transferohen në të ardhura dhe shpenzime në momentin kur ndodhin.

- **Fitim/ humbje të parealizuara**

Fitim/humbje të parealizuara janë njohur si diferencë ndërmjet kostos dhe vlerës së drejtë të një letre me vlerë. Kur letra me vlerë shitet vlera e fitim/humbjeve të parealizuara transferohet në fitim/humbje të realizuara të periudhës.

- **Transaksionet me palët e lidhura**

Palë të lidhura me Fondin konsiderohen ato palë të cilat kanë një influencë dhe kontroll në vendimet financiare dhe operacionale të Fondit.

Palë të lidhura me Fondin janë Raiffeisen Invest sh.a, e cila administron Fondin, Depozitari i cili kontrollon mirë-administrimin e Fondit si dhe Raiffeisen Bank sh.a. në cilësinë e aksionarit të Shoqërisë Administruese.

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Të përgjithshme

Përdorimi i instrumentave financiare e ekspozon Fondin ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional
- rreziku i shlyerjeve në shuma të mëdha
- rreziku i mos-diversifikimit
- rreziku rregullator
- rreziku i palës tjetër
- rreziku i performancës
- rreziku i inflacionit
- rreziku i pezullimit të shlyerjes së kuotave
- rreziku i personelit kyç
- rreziku i vleresimit të asetëve
- rreziku i kursit të këmbimit

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Fondit ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe procedurat për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut.

Struktura e administrimit të rrezikut

Sipas ligjit nr. 56/2020, datë 30.04.2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", Shoqëria administruese duhet të ketë një funksion për administrimin e rrezikut. Aktualisht, ky funksion mbahet nga Drejtori i Menaxhimit të Riskut i cili është përgjegjës për administrimin e rrezikut dhe raporton në Këshillin e Administrimit.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga institucioni financiar, për të vendosur kufizime dhe kontrole dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontrolleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut. Shoqëria përmes standardeve dhe procedurave administrative synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës të kuptojë rolin dhe detyrat e tij.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë lidhet me mundësinë që emetuesi i një instrumenti financiar të mos jetë në gjendje të shlyejë pjesërisht ose plotësisht të gjitha detyrimet e tij, cka do të kishte një impakt negativ mbi vlerën e asetëve të Fondit.

Edhe kur instrumentat e investimit zgjidhen me kujdesin dhe përgjegjshmërinë e duhur, është e pamundur që rreziku i kredisë të përjashtohet plotësisht.

Investimet në letra me vlerë sipas kategorisë së vendit janë detajuar si më poshtë:

	Letra me vlerë të tregtueshme	
	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
	Në lekë	Në lekë
Tituj të emetuara dhe garantuara nga Qeveria		
Shqiptare dhe të huaja	133,613,125.98	127,520,818.23
Tituj të emetuara nga Korporata të huaja	46,442,535.79	55,954,235.35
Kuota në fonde investimi	198,120,541.24	167,121,463.9
Vlera kontabël	378,176,203.01	350,596,517.49

Rrezikut i normave të interesit

Është rreziku që i vjen vlerës së portofolit të fondit si pasojë e paparashikueshmërisë së levizjes së normave të interesit në treg. Më konkretisht, ky rrezik vjen si pasojë e lëvizjes në kah të kundërt të çmimit të instrumenteve dhe normave të tyre të interesit. Kur normat e interesit rriten, çmimi i instrumenteve financiare bie, dhe anasjelltas. Bazuar në strategjinë e investimit të parashikuar, asetet e Fondit do të investohen në instrumente financiarë, të cilët janë lirisht të tregtueshëm çmimi i të cilave mund të ndryshojë cdo ditë.

Rreziku i likuiditetit

Ky rrezik lidhet me mundësinë që një aset financiar të mos shitet shpejt dhe me një çmim të përafërt me vlerën e tregut.

Pavarësisht objektivit të Fondit për të krijuar një portofol të përbërë kryesisht nga letra me vlerë që kanë një treg sekondar aktiv, shitja e një letre me vlerë të caktuar, në momentin e kërkuar, mund të bëhet problematike.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, normat e kursit të këmbimit dhe normat e kredive, do të ndikojnë në të ardhurat e Fondit apo vlerën e instrumentave financiarë. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të manaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Rrezikut i kursit të këmbimit

Fondi nuk është ekspozuar ndaj rrezikut kursit të këmbimit pasi investimet janë kryer në Euro.

Pavarësisht se Fondi nuk do të investojë në një monedhë të ndryshme nga Euro, nëse investitori vendos të përfshihet në transaksione këmbimi në kuadër të investimit në Fond, ai mund të pësojë humbje për shkak të luhatjeve të kursit të këmbimit.

Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë, apo të tërthortë që vjen si rezultat i gabimeve njerëzore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose te dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregtimit, te vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit.

Objektivi i Shoqërisë është të manaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare nëpërmjet procedurave të kontrollit të cilat kufizojnë ekspozimit ndaj këtij rreziku.

Rreziku i shlyerjeve të mëdha

Shlyerja e shumave të mëdha krahasuar me madhësinë e fondit mund të ketë efekt negativ në performancën e Fondit, sepse mund të jetë i detyruar që të shesë një instrument financiar në mënyrë të parakohshme, çka mund të rezultojë në humbje dhe rënie të cmimit të kuotës.

Rreziku rregullator

Rreziku rregullator lidhet me mundësinë e ndryshimeve të kuadrit rregullator, përfshirë legjislacionin tatimor. Vlera e asetëve të Fondit mund të ndikohet negativisht nga shfaqja e pasigurive në vendet ku janë bërë investimet, të tilla si tendencat politike ndërkombëtare, ndryshime në politikat e qeverisë, ndryshime në legjislacionin tatimor etj

Rreziku i mos-diversifikimit

Duke qenë se Fondi do të investojë kryesisht në Letra me Vlerë të Qeverisë, ai do të ketë një nivel të kufizuar diversifikimi dhe për rrjedhojë, mund të jetë më i ndjeshëm ndaj ndryshimeve ekonomike, politike, të biznesit ose të tjera që prekin emetues ose investime të ngjashme, krahasuar me një fond të diversifikuar. Kjo mund të rezultojë në një luhatje më të madhe të vlerës së kuotave të Fondit dhe rreziku i humbjes mund të jetë më i madh.

Rreziku i palës tjetër

Ky është rreziku që pagesa në një sistem transfertash të mos kryhet ose të kryhet me vonesë. Ai lidhet me moszbatimin e kushteve të një marrëveshjeje të paracaktuar, p.sh. mospagesën tek shitësi ose mosdorëzimin e objektit të marrëveshjes tek blerësi.

Rreziku i Performancës

Performanca e Fondit mund të devijojë nga pritshmëritë dhe një performancë pozitive nuk mund të garantohet nga shoqëria administruese.

Rreziku i inflacionit

I quajtur ndryshe rreziku i fuqisë blerëse, ky është rreziku që ndryshimet në të ardhurat reale të një investitori, pasi i ka përshtatur ato me nivelin e inflacionit, të jenë negative. Ky rrezik tregon se norma e inflacionit tejkalon normën e kthimit nga investimi. Si rrjedhim, investitori mund të pësojë realisht humbje edhe pse ai / ajo mund të ketë patur fitim në terma absolutë.

Rreziku i pezullimit të shlyerjes së kuotave

Në parim, investitori mund të kërkojë në çdo moment shlyerje të kuotave të Fondit. Megjithatë, shoqëria administruese mund të pezullojë përkohesisht shlyerjen e kuotave, në rastet e parashikuara në prospektin e fondit.

Rreziku i personelit kyc

Performanca e Fondit, pjesërisht i atribuohet aftësive profesionale të personave përgjegjës në shoqërinë administruese dhe vendimarrjes së duhur nga ana e administratorëve. Por, duke qenë se stafi i shoqërisë administruese mund të ndryshojë, vendimarrja e re mund të rezultojë më pak e suksesshme.

Rreziku i vlerësimit të aseteve

Ky lloj rreziku është tipik për tregjet jo likuide ose për tregjet që përballen me kriza financiare dhe humbje të besimit. Nëse investitorët njëkohësisht kërkojnë të shlyejnë një numër shumë të madh kuotash në Fond, shoqëria administruese mund të jetë e detyruar të shesë letra me vlerë nga portofoli i Fondit, me një çmim të ndryshëm nga çmimi i vlerësimit të tyre.

6. TË TJERA

PARAJA DHE EKUVALENTË TË SAJ

Paraja dhe ekuivalentët e saj janë mbajtur me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar dhe përbëhen nga:

	31 dhjetor 2025 Në lekë	31 dhjetor 2024 Në lekë
Depozitë	20,805,550	18,157,750
Llogari rrjedhëse në banken FIB në Lekë	733,411	1,539,177
Totali	21,538,961	19,696,927

LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme në Lekë janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2025 Në lekë	31 dhjetor 2024 Në lekë
Te arkëtueshme nga interesi i depozites	347	
Të arkëtueshme nga interesat e përlllogaritura të obligacioneve qeveritare	2,976,773	2,735,445
Te ardhura te tjera	166,394	15,016
Totali	3,143,514	2,751,470

Administratore e Përgjithshme
Edlira Konini

Specialiste e Financës dhe Kontabilitetit
Ivana Karapici